



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2018:010442

Datë: 23.01.2025

Numri i dokumentit: 06746712

PAKR.nr.571/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi - kryetar, Afërdita Bytyçi dhe Skender Çoçaj - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorës profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.O nga fshati Brestovc, Komuna Rahovec, për shkak të veprës penale, Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së (UNMIK/RREG/2003/25), duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, av. Sokol Dobruna, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.39/2019, datë 06.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, më datë 19.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, si dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.O, av. Sokol Dobruna, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.39/2019, datë 06.08.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.39/2019, datë 06.08.2024, të akuzuarin D.O, e ka shpallur fajtor për veprën penale, Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, dhe e ka gjykuar më dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vite, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Koha e kaluar në paraburgim nga data 27.02.2012 e deri me datën 27.05.2012, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 27.05.2012 e deri më datë 18.06.2015, i është llogaritur në dënimin e shqiptuar me burgim.

I akuzuari është obliguar të paguajë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej treqind (300) €, dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit, shumë prej pesëdhjetë (50) €, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari B.Enga fshati Brestovc, Komuna e Rahovecit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

- Prokuroria Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata Apelit aktgjykimin e ankimuar t'a ndryshoj ashtu që të akuzuarit D.O ti shqiptoj dënim me të lartë.

- Mbrojtësi i të akuzuarit D.O, av. Sokol Dobruna, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar t'a anuloj dhe çështjen t'a kthej në rigjykim dhe rivendosje ose aktgjykimin t'a ndryshoj ashtu që të akuzuarin D.O t'a liroj nga akuza.

Prokurori i Apelit më parashtrësën, PPA/I.nr.520/2024, datë 02.10.2024, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.39/2019, datë 06.08.2024, të

ndryshoj, ashtu që të akuzuarit D.Ot'i shqiptohet dënim më i lartë me burgim, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, D.O, av. Sokol Dobruna, të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-së, në të cilën morën pjesë: i akuzuari D.O dhe mbrojtësi i tij, av. Sokol Dobruna, ndërsa nuk prezantuan i dëmtuari B.E dhe as përfaqësuesi i tij, av. Hasan Shala si dhe nuk prezantoi as Prokurori i Prokurorisë së Apelit edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës së kolegjit, andaj, seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tyre. Në seancë mbrojtësi i të akuzuarit av. Sokol Dobruna pasi që elaboroj pretendimet e bëra në ankesë mbeti pranë propozimit të bërë në ankesë. I akuzuari D.O deklaroi se mbështet mbrojtësin e tij.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë dhe mbrojtësit të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

Pretendimet ankimore të Prokurorisë

Prokurori në ankesë konsideron se dhe përkundër faktit se gjykata i ka vlerësuar rrethanat rënduese, është dashur që ato rrethana ti shërbejnë gjykatës për caktimin e një dënimi më të rëndë, sepse dënimi i shqiptuar nuk është i mjaftueshëm dhe nuk është në proporcion me veprën penale dhe veprimin e kryesit, bazuar edhe në faktin se në vendin tonë janë shtuar veprat penale të kësaj natyre, po ashtu mënyra e kryerjes së veprës sidomos faktin se i akuzuari ka qenë së bashku edhe me familjarët e tij, ndërsa i dëmtuari i vetëm ku i janë vërsulur të njëjtit dhe i akuzuari pasi e godet me armë ashtu të shtrirë përtoke e lënë të dëmtuarin dhe largohen nga vendi i ngjarjes. Si rrethanë tjetër rënduese konsideron se duhet të merret fakti se gjuajtja me armë nga ana e të akuzuarit është bërë pikërisht në gojë të dëmtuarit ku edhe i njëjti ka pasoja të përherëshme. Se dënimet e buta, jo adekuate po ngjallin reagime të shumta në opinion publik dhe pakënaqësi se kryesve të veprave penale nuk po ju jepen dënime meritore, ashtu që nëse kryerësve të veprave penale të kësaj natyre u shqiptohen dënime jo adekuate, nuk do të mund të parandalohen me efikasitet këto lloje të veprave penale dhe njëherit nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, parashikuar me nenin 38 KPRK-së, ku parashihet se qëllimi i dënimit është që të

parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbaj persona tjerë nga kryerja e veprave penale të kësaj natyre.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit D.O, av. Sokol Dobruna, pretendon se në këtë çështje nuk ekzistojnë elementet e veprës penale që i vihet në barrë të akuzuarit, për faktin se nëse i akuzuari kishte qëllim vrasjen e të dëmtuarit, të njejtën do ta kryente pa arritur të kacafytej, e në asnjë mënyrë ta godiste me karikator të armës por do të shtinte ndaj tij. Gjykata ka dështuar të specifikoj veprimet e të akuzuarit, e të cilat nuk përbëjnë vepër penale, sepse sipas mbrojtjes i mbrojturi i tij për qëllim ka pas zbrapsjen e sulmit nga Bashkim Elshani, se goditjen që i ka dhënë i akuzuari me karikator të armës ka pasur për qëllim zbrapsjen e sulmit, e që vlerëson se janë përmbushur elementet e mbrojtjes së nevojshme apo të nevojës ekstreme. Sipas mbrojtjes gjykata ka dështuar të vërtetoj dashjen e vrasjes, respektivisht dashjen e lartë, e që në praktikën gjyqësore dashja e lartë konstatohet në rrethanat ku i akuzuari dhe i dëmtuari kanë një konflikt të mëhershëm, e që në rastin konkret nuk ekziston. Thekson se në vendimin e atakuar ka shkelje të ligjit penal për faktin se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale nga se i akuzuari ka parandaluar vrasjen e të atit, të vëllaut dhe mikut të tyre R. B, ashtu që i njejtë ka vepruar me rrezikun me të cilin është përballur në proporcion me sulmin e ardhur dhe duke ndërhyrë në armën e B.E të cilin e ka parandaluar të vazhdon të shtënat e mëtejshme. Sipas mbrojtjes, gjykata me rastin e rigjykimit ka dështuar t'i përmbush vlerësimet dhe udhëzimet e dhëna nga Gjykata e Apelit, e që ka udhëzuar për një ekspertizë të mëhershme e që në rast të mospërputhjes me ekspertizën e re gjykata inicon super ekspertizë, ka kërkuar nga Agjencia Kosovare për Forenzikë mendim shkencor lidhur me vërtetimin e një fakti të rëndësishëm, po ashtu gjykata i drejtohet forenzikës me pyetje “në momentin që është shtënë me armë dhe është goditur i dëmtuari në dorën e kujt ka mundur te jetë arma”. Shton se gjykata ka marrë përgjigje nga ekspertët se në bazë të të gjeturave nuk mund të përcaktohet personi që ka shkrep me armë zjarri dhe që është goditur B.E apo ka qenë në kontakt me armën e zjarrit, të gjitha këto për arsye se nuk janë marrë mostrat e AND-së nga arma e zjarrit, nuk janë marrë mostrat e grimcave të barotit nga personat e përfshirë si dhe nuk janë marrë mostrat biologjike trupore të lëngëta. Në rikonstruimin e vendit të ngjarjes, gjykata dhe ekspertët kanë anashkaluar faktin se në opinionin e parë të ekspertizës forenzike është përcaktuar se ka të bëjë me armë të konventuar nga 9mm me 7.65mm, fakti i cili e bënë të pamundshëm saktësinë e gjutjes së gëzhojave pas shkrepjes, gjë që e vë në mëdyshje pozicionin e të akuzuarit të përcaktuar si në rikonstruim. Sipas mbrojtjes është e pakuptimtë dhe jashtë logjikes shkencore se predha e gjuajtur nga distanca të ketë lëvizje

në fytyrën e gjëja të dëmtuarit B. E, e që sipas mbrojtjes kjo vërteton se gjuajtja ka qenë në afërsi më të vogël se 30 cm si dhe vërteton mungesën e shënjestrimit dhe mosdashjen për ta privuar nga jeta. Andaj, nga e cekura ka propozuar si më lartë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Të gjeturat për pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo Gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, gjen se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësit se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu, i njëjti është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, po ashtu, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale juridike, duke vepruar kështu konform dispozitave të nenit 369 par. 6 të KPPK-së, ku, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 të KPPK-së, ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga i akuzuari, i cili në mbrojtjen e tij nuk e ka mohuar faktin se i kishte “*meshuar (goditur) me karikator të alltisë të dëmtuarin B..... në kokë*”, pra gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Kolegji vlerëson se përshtkrimi faktik i dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar përmban faktet dhe rrethanat që janë substanciale dhe që nënvihen në mënyrën e duhur në kualifikimin juridik të veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor, në vijimësi të kësaj, argumentet e pjesës arsyetuese janë në pajtueshmëri të plotë me pjesën e dispozitivit, e që formojnë një përmbajtje koherente duke përjashtuar kundërthëniet.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe gjetjet e kësaj Gjykate

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike Gjykata e Apelit e Kosovës gjen se gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari D.O është kryes i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari D.O më datën 24.02.2012 rreth orës 16:30 në fshatin Brestovc, Komuna Rahovec, pikërisht te ura e fshatit, me dashje ka tentuar t'a privon nga jeta tani të dëmtuarin B.Enë atë mënyrë që pas i dëmtuari B.E fjaloset më Gani Orllatin - babain e të akuzuarit D., i akuzuari kishte shkuar në vendin e ngjarjes i armatosur me revolen e tipit "Woltran", të kalibrit 9mm, me numër serik ..., ku me t'u afruar në një distance 1 m deri 1.5 m me të dëmtuarin B... me të njëjtën revole kishte shtënë në drejtim të dëmtuarit B.. duke e goditur me një predhë në buzën e sipërme të gojës të cilit i shkakton plagë shkuese e cila predhë nga dinamika e veprimit në rrugën e vet ka kaluar buzën e sipërme të gojës, duke përfunduar në indet e buta në hapësirën e gojës, me çrast i ka shkaktuar plagë shqyese pëlçitëse, e pasi që i dëmtuari B... ishte rrezuar për toke, i akuzuari e ka goditur me dorëz të revoles pas koke, me të cilin veprim të dëmtuarit B... i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore në pjesën e pasme të kokës, e ku në momentin kur e ka goditur të dëmtuarin B... me dorëz të revoles, i ka shkrepur revolva jashtë objektivit të akuzuarit duke e goditur me një predhe vëllain e tij A. O ti, të cilit i ka shkaktuar lëndime trupore.

Deri të kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave, siç janë: Raportet mjekësore të lëshuara nga Spitali Regjional në Prizren, me numër 30/2012 të datës 24.02.2012, në emër të të dëmtuarit Bashkim Elshani, Raportit të përbashkët të hartuar nga eksperti i mjekësisë ligjore Cenë Morina edhe eksperti i balistikës prof. Hazir Kelmendi, të datës 23.05.2012 dhe datës 25.05.2012, Fletë lëshimi i QKUK-së, Klinikës së Kirurgjisë Maksilofaciale me nr.32/13 të datës 16.03.2012, në emër të dëmtuarit Bashkim Elshani, Shikimi në pistoletën e tipit Voltran, 9mm, me numër serik 81195, si dhe të dy predhave dhe dy gëzhhojave të kalibrit 7.65mm, Fotoalbumet e vendit të ngjarjes, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes datë 24.02.2012, Leximi i mendimi të ekspertit të balistikës Ilir Kukaj i datës 29.05.2018, me rastin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes, Leximi i mendimi të ekspertit mjeko ligjorë Flamur Blakaj i datës 29.05.2018, me rastin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes,

Ekspertiza e përpiluar nga AKF-ja, AKT/2024-257 e datës 28.05.2024, Dëshmia e dëshmitarit Gani Orllati, tani i ndjerë, e dhënë në shqyrtimin gjyqësor, PKR.nr.35/16 me datë 07.06.2016, Dëshmia e dëshmitarit Rifat Bytyqi, tani i ndjerë, e dhënë në shqyrtimin gjyqësor, PKR.nr.35/16, me datë 05.06.2015, e cila është lexuar edhe në procesverbal të ri-shqyrtimit gjyqësor të datës 14.11.2018, si dhe pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit e dhënë në shqyrtimin gjyqësor.

Duke analizuar raportet mjekësore të lëshuara nga Spitali Regjional në Prizren, me numër 30/2012 të datës 24.02.2012, në emër të dëmtuarit B.E , Raportin e përbashkët të hartuar nga eksperti i mjekësisë ligjore Cenë Morina edhe eksperti i balistikës prof. Hazir Kelmendi, të datës 23.05.2012 dhe datës 25.05.2012 dhe fletë lëshimi i QKUK-së, Klinikës së Kirurgjisë Maksilofaciale me nr.32/13, të datës 16.03.2012, në emër të dëmtuarit Bashkim Elshani, kolegji gjen se me të drejtë gjykata shkallës së parë ka konstatuar se të dëmtuarit B.E dëmtimet i janë shkaktuar nga predha e armës se zjarrit dhe atë derisa ishin në kacafytje me Gani Orllatin dhe D.O , se dëmtimet si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar i ka marrë sa ka qenë në këmbë, i dëmtuari ka pësuar lëndime në buzën e sipërme të gojës duke përfunduar në indet e buta në hapësirën e gojës, të cilat lëndime janë klasifikuar si plagë shqyese-pëlcitëse të shkaktuar nga dinamika e veprimit të predhës se armës se zjarrit si dhe lëndimet e shkaktuara nga dorëza e revoles pas koke të i dëmtuari Bashkim, është vërtetuar se këto lëndime të shkaktuara tek i dëmtuari B.Ekualifikohen si dëmtime të rënda trupore.

Nga Ekspertiza Balistike me rastin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes me dt.17.05.2018; deklarata e ekspertit balistik Ilir Kukaj dhe raporti i rikonstruimit të vendit të ngjarjes nga AKF, ka rezultuar se pozita e gjuajtësit ka qenë afër mesit të rrugës automobilistike, kahja e lëvizjes - drejtimi i Rahovecit, dhe sipas deklaratës së të akuzuarit D.O të dhënë me rastin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes me dt.17.05.2018, në prezencën e të gjitha palëve dhe mbrojtësit të tij, ku ka deklaruar se kur ka arritur në vendin e ngjarjes është ndalë në mes të rrugës automobilistike kahja e lëvizjes-drejtimi i Rahovecit, rezulton se gjendja faktike është vërtetuar drejtë, si dhe nga deklarata e ekspertit të lartcekur i cili ka theksuar se nga arma Woltran, model P99A, me numër serik 8-11195, e cila është objekti i ekspertimit, janë gjuajtur dy predha dhe janë gjetur dy gëzhoja në vendin e ngjarjes, dhe nga kjo armë është shkrepur dy here, njëra predhë e shkrepur është nxjerrë nga i dëmtuari B.Enë Klinikën Maksifaciale, e sa i përket predhës tjetër e cila ishte në trupin e të dëmtuari Agron Orllati, i njëjti e ka nxjerr nga trupi, por nuk ka treguar se ku e ka nxjerrë dhe nuk e ka dorëzuar për ekzaminim duke u arsyetuar se nuk e ka marrë, andaj nga kjo

konstatohet se predha të cilën është qëlluar i dëmtuari Bashkim është gjuajtur nga arma Woltran, nga e cila ka shtënë personi që ka qenë në mes të rrugës automobilistike ku edhe janë gjetur gëzhojat, dhe në pozitën në mes të rrugës, 1m-1.5 m, larg nga të dëmtuarit Bashkim, ka qenë i akuzuari Driton, andaj edhe kolegji pajtohet me përfundimin e gjykates se shkallës së parë se nga arma e lartcekur ka gjuajtur i akuzuari D.O. Në bazë të të dhënave në raportin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes nga AKF, konstatohet se përdoruesi i armës D.O ka qenë i pozicionuar në mes të rrugës, në anën e djathtë në drejtim të Rahovecit, ballë përballë me të dëmtuarin Bashkim, ku edhe janë gjetur gëzhojat e armës në afërsi në anën e djathtë nga vendi i gjuajtjes, dhe dy predhat janë gjuajtur nga arma Woltran, dhe se gjuajtësi me pistoletën Woltran, në raport me gëzhojat ka qene diku në një kënd 45 shkallë të kahjes në drejtim të Rahovecit, ku është plagosur B.E dhe Agron Orllati. Faktin se këto gjuajtje janë shtënë vetëm nga një person e vërteton edhe Opinioni i rikonstruimit të shtënave me armë zjarri i dt.28.05.2024, i lëshuar nga AKF edhe pse i dëmtuari Agron e ka nxjerre predhën në një klinikë emrin e të cilës nuk e ka treguar dhe nuk ka parashtruar raport për këtë, andaj gjykata shkallës së parë me të drejtë i ka falur besimin Ekspertizës Balistike me rastin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes me dt.17.05.2018, dhe deklaratës se ekspertit balistik Ilir Kukaj, sepse janë në harmoni edhe me deklarimin e të dëmtuarit Bashkim Elshani.

Gjykata e shkallës nga provat e administruara dëshmitë e dëshmitarëve dhe provave materiale dhe pjeserisht nga vetë mbrojtja e të akuzuarit se i njëjti ishte ditën kritike në vendin e ngjarjes me të drejtë ka vërtetuar faktin se i akuzuari me dashje ka tentuar ta privon nga jeta tani të dëmtuarin B.E. Me konkretisht gjendja faktike, mbështetet nga deklarata e të dëmtuarit B. E, i cili ka përshkruar ngjarjen dhe rrjedhimisht lëndimet që kishte pësuar. Andaj, Gjykata e Apelit e Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lartë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk kanë mbetur pa u vërtetuar faktet vendimtare. Gjithashtu, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji penal siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë, dhe se veprimet e të akuzuarit i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, se për këtë veprë penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarit.

Pretendimet ankimor të prokurorisë dhe të mbrojtësit përkitazi me vendimin mbi dënim

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e prokurorit për një dënim me të ashpër, ndërsa të mbrojtësit të akuzuarit për lirim nga dënimi, nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar në bazë të nenit 73 lidhur me nenin 74 të KPRK-së, me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat mund të ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj të akuzuarit. Kështu gjykata si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e lartë të dashjes për faktin se i akuzuari edhe pasi që kishte shtënë me armë në drejtim të dëmtuarit duke e goditur me një predhë siç është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, e kur i dëmtuari ishte rrezuar për toke, i akuzuari e kishte goditur me dorëz të revoles pas koke duke e lënë për të vdekur të dëmtuarin Bashkim dhe kishte ikur nga vendi i ngjarjes. Gjykata në bazë të nenit 41 të KPK-së, vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, dhe në këtë mënyrë do të ndikoj në arritjen e qëllimit të dënimit të paraparë me nenin 38 të KPRK-së, si masë për rehabilitimin e të akuzuarit por edhe si masë për parandalimin e të akuzuarit dhe personave të tjerë kryes potencial të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Një vlerësim të tillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e prokurorit se dënimi është i butë dhe jo adekuat në raport me veprën penale, janë pretendime të pa bazuara dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me të rëndë, kurse në anën tjetër mbrojtësi nuk përmend ndonjë rrethanë lehtësuese dhe pse dënimi është në minimumin e paraparë ligjor përveç se ka pretenduar që i akuzuari të lirohet nga akuza, megjithatë mbi gjendjen faktike të vërtetuar një pretendim i tillë është i pa justifikuar, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj Gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Për rrjedhojë, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë së veprës së kryer penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e pasojave të shkaktuara dhe se me të

do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.571/2024, datë 19.12.2024

B. Profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Fitore Batatina

Afërdita Bytyçi

Xhevdet Abazi

Skender Çoçaj